STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 27 dhjetor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE PERPJEKJET E PASTRIMIT, HEQJES DHE ELEMINIMIT TE MBETURINAVE DO TE FILLOJNE NE FAJER AJLEND (FIRE ISLAND)

FEMA ka miratuar 30 milionë dollarë për përpjekjet e pastrimit, heqjes dhe eleminimit në Fajër Ajlënd (Fire Island) që do të përfshijnë shkatërrimin e plotë të shtëpive të dëmtuara

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Shteti i Nju Jorkut (New York State), FEMA dhe bashkitë vendore do të fillojnë procesin e përpjekjeve të heqjes së mbeturinave në Fajër Ajlënd (Fire Island). Një shumë e vlerësuar në 30 milionë dollarë është miratuar për pastrimin, heqjen dhe eleminimin e mbeturinave nga Uragani Sendi (Sandy) në Fajër Ajlënd (Fire Island). Korpusi i Inxhinierëve të Ushtrisë (Army Corps of Engineers) (Corps) do të mbikqyrë projektin dhe të vazhdojë të ndihmojë përpjekjet e pastrimit me Shtetin e Nju Jorkut (New York State) dhe komunitetet e Fajër Ajlënd (Fire Island) të shkatërruara nga Urgani Sendi (Sandy) pasi kërkesat për të Drejtën e Hyrjes të jenë paraqitur nga pronarët e shtëpive.

“Fajër Ajlënd (Fire Island) ka një rëndësi të madhe për ekonominë dhe cilësinë e jetës për Qarkun Safolk (Suffolk County) dhe Shtetin tonë,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Jam jashtëzakonisht krenar për bashkëpunimin ndërmjet bashkësive, udhëheqësve të tyre dhe agjencive qeveritare në trajtimin e çështjeve logjistike që mund të pengojnë përpjekjet e pastrimit në Fajër Ajlënd (Fire Island).”

“Fajër Ajlënd (Fire Island) ka sfida të veçanta për t’u përballur ndërsa fillojmë procesin e pastrimit, heqjes dhe eleminimit,” tha Komisioneri i Divizionit të Sigurisë së Vendit & Shërbimeve të Emergjencës të NYS Xherom M. Hauer, Komisioneri. “Sfida thelbësore dhe unike është se nuk ka asnjë infrastrukture ‘normale’ për të transportuar vëllimin e madh të mbeturinave të përziera, të cilat përfshijnë pajisjet e prishura dhe pjesët e shkatërruara nga shtëpitë. Ka gjithashtu mbeturina bimore, të druve dhe të ndërtimit që do të kërkojnë planifikim të kujdesshëm për të kryer heqjen dhe eliminimin.”

“Burimet e siguruara nga FEMA dhe Korpusi i Inxhinierëve të Ushtrisë së SHBA-së (US Army Corps of Engineers) për të trajtuar heqjen e mbeturinave në Fajër Ajlënd (Fire Island) janë thelbësore për ekonominë e Qarkut Safolkut (Suffolk County),” tha Ekzekutivi i Qarkut Safolk (Suffolk County) Stiv Bellone. “Ekspertiza dhe njohuria e thellë e këtyre dy agjencive është e mirëpritur ndërsa komuniteti i Fajër Ajlënd (Fire Island) përballet me sfidat e veçanta që kanë lidhje me heqjen e mbeturinave.

Falënderoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për udhëheqjen e vazhdueshme të tij për të siguruar se të gjitha komunitetet e prekura nga Super Stuhia Sendi (Sandy) marrin burimet e nevojshme për t'u rindërtuar."

"Heqja e mbeturinave nga komunitetet tona të Fajër Ajlënd (Fire Island) është një përparësi e lartë dhe falënderoj Guvernatorin për reagimin kaq shpejt," tha Mbikqyrësi i Qytetit Brukhejvën (Brookhaven) Ed Romein. "Eshtë vetëm nëpërmjet ndihmës federale, shtetërore dhe të bashkive vendore që një punë e kësaj shkalle mund të përfundojë në kohë për sezonin e verës. Kam patur disa takime me pronarët e shtëpive dhe shoqatat vendore të Fajër Ajlënd (Fire Island) dhe kam besim se do të kemi një nivel të lartë suksesi në sigurimin e të paktën 75% të të Drejtës së Hyrjes, si dhe bashkëpunimin e plotë të tyre përgjatë të gjithë projektit."

"Ndihma dhe bashkëpunimi me partnerët tanë federalë dhe shtetërore është thelbësor ndërsa punojmë për të rimëkëmbur digën e rëndësishme natyrore të Long Ajlënd (Long Island), që është Fajër Ajlënd (Fire Island)," tha Mbikqyrësi i Qytetit Islip Tom Kroçi. "Qyteti ynë ka vepruar shpejt për t'u siguruar se banorët tanë kanë dijeni për ndihmën që FEMA dhe Korpusi i Inxhinierëve të Ushtrisë së SHBA-së (U.S. Army Corps of Engineers) kanë premtuar për pronarët e pronave në Islip dhe Fajër Ajlënd (Fire Island) dhe presim të arrijmë pragun e përgjigjeve prej 75% deri për festat."

Kryetari i Oshean Biç (Ocean Beach) të Fajër Ajlënd (Fire Island) Xhejms Mellët tha, "Vlerësojmë mjaft ndihmën e Guvernatorit në pastrimin e mbeturinave të stuhisë në komunitetin tone dhe veçanërisht vlerësojmë përkushtimin që Guvernatori na ka dhënë në marrjen e hapave të mëtejshëm që do të na nevojiten për të rikthyer fshatin tonë - dhe të gjithë Fajër Ajlënd (Fire Island) - në gjendjen e plotë."

Kryetari i Sollteir (Saltaire) Robert L. Koks tha, "Fshati i Sollteir (Saltaire) dhe komunitetet tona fqinje në Fajër Ajlënd (Fire Island) kanë shumë punë përpara ndërsa rimëkëmbemi nga kjo stuhi historike. Jemi mirënjohës ndaj Guvernatorit Kuomo (Cuomo) për udhëheqjen e tij dhe ndihmën e përpjekjes së Korpusit të Ushtrisë (Army Corps) në pastrimin e mbeturinave dhe vështrojmë nga e ardhmja për të njëjtin shpirt bashkëpunimi ndërmjet juridiksioneve federale, shtetërore dhe vendore ndërsa rikthejmë infrastrukturën dhe plazhet tona në kushtet përpara stuhisë."

"Si ishulli pengesë që mbron bregun jugor të Long Ajlënd (Long Island), pësuam një goditje shkatërruese nga Sendi (Sandy)," tha Suzi Goldhërsh, presidente e Shoqatës së Fajër Ajlënd (Fire Island). "Por jemi komunitete me shumë burime dhe shumë të fortë. Me ndihmën vendimtare të Guvernatorit, Ekzekutivit të Qarkut Stiv Bellone dhe Qyteteve, do të punojmë me Korpusin e Ushtrisë (Army Corps) për të pastruar mbeturinat dhe pastaj për të rindërtuar sistemin tonë të dunave sa më shpejt që të jetë e mundur."

Përpjekjet në Fajër Ajlënd (Fire Island) do të kenë shumë pengesa. Ndryshe nga komunitetet në kontinent ku ka vend në trotuare dhe shirita të përdorimit përpara shtëpive të njerëzve për të vendosur përkohësisht objekte të tilla derisa kamionat bashkiakë të higjenës ose transportuesit private të mund t'i mbledhin ato, nuk ka vend në rrugicat e ngushta dhe vendkalimet që shkojnë përmes Fajër Ajlënd (Fire

Island). Përveç kësaj, ka kufizime të peshave në ura dhe trotuare, gjë që do t'a bëjë mbërritjen tek dhe transportimin e mbeturinave një sfidë.

Bashkitë vendase do t'u dërgojnë me postë banorëve një kërkesë për të Drejtën e Hyrjes, e cila kërkohet që Korpusi (Corps) të fillojë pastrimin. Një e Drejtë e Hyrjes është një formular ligjor që i jep Korpusit (Corps) dhe kontraktorëve të tij leje për të hyrë në një pronë private dhe për të hequr mbeturinat. Kjo marrëveshje sqaron të drejtat e pronarit të shtëpisë dhe përcakton kufijtë dhe përgjegjësitë e Korpusit të Inxhinierëve të Ushtrisë (Army Corps of Engineers).

Puna pritet të fillojë në fund të Janarit dhe duhet të përfundojë në kohë për sezonin turistik.

Informacion i hollësishëm mbi pastrimin dhe udhëzimet në lidhje me procesin e të Drejtës së Hyrjes do t'u sigurohen banorëve nga secila bashki dhe do të bëhet i disponueshëm në internet në faqen publike në internet të secilës bashki.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418